

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07
Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Gjykatësi i Vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi Parashtrues: Mbrojtësi kujdestar i Nasim Haradinajt

Data: 16 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris QC

Hju Bauden

Mbrojtësi i Nasim Haradinajt

Bas Martens

PARASHTRIME MBI PROCEDURËN E RISHIKIMIT TË AKTAKUZËS

1. Në përgjigje ndaj Urdhrit për Parashtrime mbi Procedurën e Rishikimit të Aktakuzës të datës 11 nëntor 2020 (F00065), në emër të Nasim Haradinajt, parashtrojmë se qëndrimi i Mbrojtjes është që Aktakuza duhet të bëhet e disponueshme për Mbrojtjen dhe se mund të bëhen parashtrime gjatë rishikimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.
2. Në marrjen e vendimit për këtë, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Vetëm që të konstatojë se Mbrojtjes duhet t'i lejohet qasje në Aktakuzën e plotë dhe të paredaktuar dhe në të gjitha materialet e mbledhura nga ZPS-ja në këtë çështje. Mbrojtja përsërit se kjo nuk është çështje për krime të luftës. Kjo çështje ka të bëjë me një person që ka dalë në tri konferenca shtypi në shtator 2020 dhe pretendohet se ka shpërndarë informacion konfidencial.

Pas paraqitjes së parë më 1 tetor 2020, ZPS-ja i ka bërë të disponueshme transkriptet e këtyre konferencave të shtypit. Në ato transkripte, të cilat në këtë moment janë e vetmja provë mbështetëse e akuzave, nuk ka tregues se janë kryer vepra që çojnë në dyshime për hakmarrje kriminale e as për shkelje ose nxjerrje të ndonjë sekreti.

3. Transkriptet tregojnë për peshën e çështjes dhe rëndësinë dhe peshën e akuzave. Mbrojtja parashtron se çështja është shumë më pak e rëndë se sa duket në shikim të parë. Mbrojtja do të kërkojë lirim të z. Haradinaj në seancën e ardhshme me Gjykatësin e Vetëm, ku do të vendoset në lidhje me mbajtjen në paraburgim. Meqenëse z. Haradinaj është në paraburgim që nga 24 shtatori 2020, seanca pas dy muajsh do të mbahet së shpejti. Parimi i barazisë së palëve parasheh që Mbrojtjes duhet t'i jepet kohë dhe mundësi e mjaftueshme për të shqyrtuar Aktakuzën dhe materialin mbështetës me qëllim që Mbrojtja të përgatitet për seancën e ardhshme në lidhje me paraburgimin para gjykimit. Në këtë moment, ZPS-ja ka dijëni të plotë për Aktakuzën dhe provat mbështetëse, të cilat ZPS-ja mund t'i përdorë kundër z. Haradinaj në seancën e

ardhshme. Mbrojtja ka vetëm fletarrestimin dhe transkriptet. ZPS-ja i ka të gjitha dokumentet. ZPS-ja ka mundur dhe është dashur ta jepte Aktakuzën e plotë dhe të paredaktuar me të gjitha dokumentet mbështetëse në këtë çështje, në mënyrë që ato të mund të shqyrtohen deri në fund të tetorit 2020. ZPS-ja ka vendosur t'i mbajë këto dokumente *ex parte*.

4. Për arsyet e lartpërmendura, Mbrojtja kërkon që Gjykatësi i Vetëm të konstatojë se Mbrojtjes duhet t'i lejohet qasje në Aktakuzën e plotë dhe të paredaktuar dhe në të gjithë materialin mbështetës dhe t'i klasifikojë këto dokumente si 'publike'.

[Numri i fjalëve në origjinal: 512]

_____/nënshkrimi/____

Bas Martens

Mbrojtësi kujdestar i Nasim Haradinajt

17 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë